



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM

Nr. 155, datë 14.04.2021

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT
Z.ERJON ÇELA, PËR GJYKIMIN E DISA ÇËSHTJEVE GJYQËSORE NË
GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe në pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me Shkresat nr. 425 prot., datë 08.04.2021; nr.426 prot., datë 08.04.2021; nr. 427 prot., datë 08.04.2021 dhe nr. 434 prot., datë 08.04.2021, protokolluar në Këshill me aktet nr. 1486 prot., datë 09.04.2021; nr. 1487 prot., datë 09.04.2021; nr. 1488 prot., datë 09.04.2021 dhe nr. 1504 prot., datë 12.04.2021, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

- Gjyqtari i skemës së delegimit z. Erjon Çela caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar:
 - Çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal”;
 - çështjen penale me të pandehur: {...}, Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 134/3, 134/2, 333/a/2, 334/1, 287/b-284 të Kodit Penal”;
 - çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}dhe {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/1-28, 333/a/2 të Kodit Penal”;
 - çështjen penale me të pandehur: Dritan Gramozi, Arjan Shehu; Akuza: “Nenet 198/2, 190/2, 298/2, 28/4, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal”.
- Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit Erjon Çela, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR